

AKR EDHE NË SHTETET E BENELUKSIT

Kohë më parë, me iniciativën e disa bashkatdhetarëve tanë dhe në bashkëpunim me Kryesinë Qendrore të AKR-se, në Bruksel, u formua Këshilli Iniciues i Degës së AKR-së për shtetet e Beneluksit.

Këshilli iniciues vendosi që Kuvendi zgjedhor punues të mbahet në muajin shtator.

Ky këshill për kryetarë zgjodhi, Z. Fatime Ahmeti ndërsa për sekretar Z. Asllan Krasniqin.

Që në takimin e parë u vërejt një interesim i madh për të aderuar në këtë parti dhe ajo çka vlen për t'u theksuar është fakti se u vërejt një strukturë e bashkatdhetarëve tanë, me njerëz intelektual, afaristë të cilët gëzojnë një autoritet në Belgjikë dhe më gjerë.

Në këtë tubim mbretëroi bindja se AKR, edhe pse si forcë e re politike është një shtytje e madhe e proceseve pozitive demokratike në Kosovë, dhe se kjo parti me vizionin e saj të qartë e pragmatik, ka bërë që në mesin e saj, për ditë e më tepër të aderojnë njerëz nga të gjitha shtresat sociale të popullit tonë.

Këshilli Iniciues i AKR-së iu bënë apel të gjithë bashkatdhetarëve në shtetet e Beneluksit e veçmas të rinjve që të aderojnë në këtë subjekt politik, sepse ky do të jetë vend për ide të reja, për tolerance dhe prosperitet, ngase kjo parti udhëhiqet nga Z. Behgjet Pacolli, një personalitet me virtyte të larta njerëzore dhe kombëtare, një biznesmen shumë i suksesshëm i cili ka hyrë në jetën politike vetëm për t'i dhënë Kosovës e jo për të marrë nga ajo dhe këtë e ka dëshmuar dhe e dëshmon çdo ditë.

Këshilli iniciues i AKR-së për Beneluks

AKR BENELUX

Av. Commandant Vander Meeren 7 - 1070 Bruxelles

<http://www.akr-ks.info> e-mail: akr.benelux@gmail.com

Fatime Ameti Kryetare Tel:+32.475536028 e-mail:fatime.ameti@gmail.com

Asllan Krasniqi Sekretare – Arkatare Tel:0032.475.417575 – e-mail: asllan.krasniqi@gmail.com

Kosovë - USA - Canada - Switzerland - France - Italy - England - Denmark - Norway - Sweden - Finland - Germany - Albania - Kosovo - Macedonia - Croatia - Bosnia - Slovenia - Turkey.